



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 31 TETOR 2017

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 31. OKTOBRA 2017. GODINE

TETOR - OKTOBAR
2017

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-125 o budžetu Republike Kosova za 2017. godine

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të caktuar me vendimin e seancës plenare, datë 26 tetor 2017.

Fillojmë me të vetmen pikë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Komisionet parlamentare në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë 26 tetor 2017, e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

LUMIR ABDIXHIKU: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, numër 06/5-010, datë 26. 10. 2017, në mbledhjet e mbajtura më 27, 30 dhe 31 tetor e shqyrtoi Projektligjin numër 06/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit numër 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Komisioni e ka shqyrtuar projektligjin dhe kërkesat buxhetore të organizatave buxhetore që i janë adresuar Komisionit. Po ashtu, ne i kemi shqyrtuar edhe propozimet e Ministrisë së Financave, si edhe amendamentet e propozuara nga deputetët që janë dërguar te Komisioni.

Sa u përket amendamenteve të deputetëve, në Komision janë adresuar gjithsej tetë amendamente.

Amendamentet e adresuara në Komision nga deputetët Bekim Haxhiu, tri; Mërgim Lushtaku, një; Labinot Tahiri, një, janë tërhequr pas sqarimeve që ministri ua ka dhënë deputetëve në fjalë dhe arsyeshmërinë se këto amendamente do të përfshihen në Buxhetin e vitit të ardhshëm.

Ndërsa amendamentet e deputetit Avdullah Hoti, amendamenti 1 dhe 2, janë me përkrahje të Komisionit, kurse amendamenti 3 është tërhequr.

Në këto amendamente vlen të përmendet amendamenti 2, i cili ka qenë propozim i Komisionit që projekti për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Gjilan, me këtë ndryshim shuma totale e projektit do të jetë 1 milion e 850 mijë euro, krahasuar me 1,7 milion euro propozim i Komisionit dhe 150 mijë euro, të cilat kanë qenë të përfshira në Buxhet.

Po ashtu, vlen të përmendet amendamenti 12, i cili ka të bëjë me mjetet për sigurimet shëndetësore, në shumë prej 11 milionë eurove.

Unë, në emër të Komisionit, dëshiroj ta falënderoj edhe ministrin për mirëkuptim edhe anëtarët e Komisionit për kthimin e këtyre mjeteve, të cilat me rekomandim të Komisionit janë destinuar dhe do të destinohen për blerjen e barnave esenciale dhe për shërim jashtë vendit.

Për amendamentet 15 dhe 16, të deputetit Avdullah Hoti, Komisioni ka vlerësuar se janë të rëndësishëm të përkrahen.

I pari ka të bëjë me Fabrikën e ujërave të zeza në Pejë dhe i dyti me ndërtimin e Fakultetit Ekonomik dhe Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Amendamentet tjera janë të propozuara nga Ministria e Financave dhe të përkrahura nga Komisioni, duke i vlerësuar si të rëndësishme dhe të arsyetuara mirë nga Ministria e Financave.

Ndërsa amendamentet 3, 4, 11, 13 dhe 19 janë rezultat i kursimeve të propozuara nga Ministria e Financave për shpërndarjen e mjeteve të ndara të reja buxhetore të propozuara me këto amendamente.

Gjithashtu, komisionet e përhershme të Kuvendit e kanë shqyrtuar projektligjin në fjalë, si dhe amendamentet e propozuara të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, dhe i kanë paraqitur rekomandimet e tyre. Pas rekomandimeve të tyre, ne kemi mbajtur edhe një mbledhje tjetër, në të cilën e kemi kaluar këtë raport.

Pra, për fund, Komisioni rekomandon që amendamentet e propozuara nga ne të miratohen në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e vitit 2017 janë propozuar 18 amendamente.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa.

Amendamenti 1.

Kush është kundër? Ok!

Mendova t'i votojmë amendamentet formalisht, në qoftë se ka kundër me dorë, në qoftë se nuk ka kundër, unë e marr të aprovuar.

Kush është kundër? Abstenim? Nuk ka! Kundër nuk ka, një abstenim Armendi, dy abstenime, një kundër, një abstenim. A e marrim të mirëqenë të gjithë të tjerët. Jo! Atëherë, a ka mundësi të votojmë diqysh?

Vetëm pak, nëse kemi marrëveshje, amendamentet zakonisht i kemi kaluar kështu. A dëshironi pra të shkojmë amendament për amendament në mënyrë elektronike, apo doni në mënyrë formale.

“Vetëvendosje”, grupi juaj parlamentar, a dëshironi të shkojmë në mënyrë formale, a në mënyrë elektronike? Regjia, fjalën Glauk Konjufcës.

GLAUK KONJUFCA: Për ne do të ishte shumë në rregull që të votojmë në mënyrë elektronike, sepse nuk dëshirojmë që mosvotimi të merret si votë për.

KRYETARI: Atëherë e respektojmë të qenët e të gjithë deputetëve që të votojmë në mënyrë elektronike. Kisha pasur dëshirë ta di veç kush nuk ka kartelë.

A ka dikush që nuk ka kartelë? Një pa kartelë. Kolege deputete, me dorë! Dy qenkan pa kartelë, me dorë. Kush është pa kartelë, kur voton e tregon qëndrimin për, kundër a abstenim.

Regjia, përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Amendamenti 1.

Dy kolegë deputetë me dorë, si e kanë votën? Për!

73 deputetë kanë votuar, 69 për, 2 kundër dhe 2 abstenime. Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

87 deputetë, dy kolegët me dorë, tash me kartelë, me dorë prapë, për? Ok-ej!

86 deputetë kanë votuar për arsye se Memli tani voton me kartelë.

81 për, 2 kundër dhe 3 abstenime. Kalon!

Amendamenti 3.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me dorë, votimi për.

72 deputetë kanë votuar, 67 për, 1 kundër dhe 4 abstenime.

Amendamenti 4.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kolegia për, po ashtu.

Në qoftë se më dëgjon kolegia që voton për, në qoftë se është çdo herë për, unë e marr të mirëqene, e numëroj automatikisht, nuk ka nevojë ta ngrejë dorën. Kur e ke votën tënde kundër ose abstenim ngrite dorën, tjerat herë e marr të mirëqenë çdo herë e numëroj.

81 deputetë kanë votuar, 70 për, 7 kundër, 4 abstenime.

Ta keni parasysh, një votë është me dorë, të cilën e fus në këtë radhitje.

Amendamenti 5.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

91 deputet kanë votuar, 92 deputetë... zoti Kurteshi, cila është vota juaj? Për! Atëherë, 92 deputetë kanë votuar, 86 për, 1 kundër, 5 abstenime.

Amendamenti 6.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

73 deputetë kanë votuar, 66 për, 2 kundër, 5 abstenime.

Amendamenti 7.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

84 deputetë kanë votuar, 80 për, 1 kundër, 3 abstenime.

Amendamenti 8.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

72 deputetë kanë votuar, 64 për, 2 kundër, 6 abstenime.

Amendamenti 9.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

83 deputetë kanë votuar, 78 për, 3 kundër, 2 abstenime.

Amendamenti 10.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

88 deputetë kanë votuar, 63 për, 20 kundër, 5 abstenime.

Te amendamenti 10, edhe Labinoti ishte për. Po! Më fal, Labinot, nuk ke kartelë, a? Do ta kemi marrëveshjen kështu, unë e marr të mirëqenë votimin tuaj për, në qoftë se keni kundër e ngrini dorën, ose për abstenim, në raste tjera çdoherë e marr të mirëqenë votën tuaj.

Amendamenti 11.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

72 deputetë kanë votuar, 63 për, 6 kundër, 3 abstenime.

Amendamenti 12.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

87 deputetë kanë votuar, 84 për, 1 kundër, 2 abstenime.

Amendamenti 13.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

75 deputetë kanë votuar, 69 për, 3 kundër, 3 abstenime.

Amendamenti 14.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

91 deputetë kanë votuar, 68 për, 19 kundër, 4 abstenime.

Amendamenti 15.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

96 deputetë kanë votuar, 92 për, s'ka kundër, 4 abstenime.

Amendamenti 16.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

92 deputetë kanë votuar, 88 për, s'ka kundër, 4 abstenime.

Amendamenti 17.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

82 deputetë kanë votuar, 69 për, 3 kundër, 10 abstenime.

Amendamenti 18.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

81 deputetë kanë votuar, 74 për, 1 kundër, 6 abstenime.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

76 deputetë kanë votuar, 61 për, 15 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Para se ta përfundoj seancën, i kisha lutur shefat e grupeve parlamentare në sallën C-301, kemi takim për konkursin për një anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance. Mirupafshim në seancën plenare të radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*